



UNIVERSITETI I MITROVICËS

“ISA BOLETINI”

**TREGUESIT KRYESORË TË
PERFORMANCËS**

Fjala e Rektorit

Të nderuar,

Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB), ka krijuar mundësi të mëdha për të rinjtë e rajonit, të cilët duke u bërë pjesë e këtij institucioni të arsimit të lartë në Kosovë, njëkohësisht të bëhen pjesë e tregut të punës. Në UMIB janë të akredituara 20 programe, të cilat janë mjaft atraktive dhe të kërkuara jo vetëm brenda, por edhe jashtë vendit. Si të tilla ato paraqesin një derë të hapur për ata që duan të ecin në hap me të rejtat në shkencë dhe gjithashtu në tregun global të punës. Përveç programeve, kabineteve, laboratorëve që ofrohen në UMIB, një segment tepër të rëndësishëm paraqet bashkëpunimi me kompanitë publike dhe ato private në vend. Si rrjedhojë studentët tanë mund të kryejnë praktikën në kompanitë që ndërlidhen me natyrën e studimeve, duke e zënë shpejtë hapin e teknologjisë së re. Në kuadër të Universitetit tonë, tashmë janë krijuar edhe mekanizma të tjerë në shërbim të studentëve, të cilët poashtu ndikojnë në rritjen e cilësisë së punës dhe përgatitjes së kadrove të reja. Qendra e Inovacionit, asociacioni “Alumni”, Qendra për Zhvillim të Karrierës dhe Bordi Këshillëdhënës që përbëhet prej njerëzve të biznesit dhe universitetit, shpërfaqin një qasje të re për universitetin dhe për studentët. Konferencat shkencore që tashmë po bëhen tradicionale, kanë krijuar një imazh të një institucioni të mirëfilltë shkencor. Ndërsa ngjarjet, sikur “Panairi i karrierës dhe punës”, po e pasurojnë kalendarin e aktiviteteve universitare dhe po hapin shtigje të reja për të gjithë ne. Këta hapa kanë bërë që UMIB-i në vitin 2019 të ngritet për 4 mijë vende në ranglistën e universiteteve botërore, për herë të parë i dyti në nivel vendi në listën e universiteteve publike. Në pozitën e dytë në nivel vendi, UMIB-i është renditur edhe në ranglistën e webometrics të publikuar në janar 2020. Kampusi i ri universitar ka krijuar mundësi të mëdha për të gjithë, qoftë si studentë, qoftë si mësimdhënës. Ky është një rrugëtim i përbashkët drejtë suksesit. Të gjitha këto janë suksese të prekshme dhe të matshme. Në këtë kontekst, ato ofrojnë mundësi krahasimi gjatë rrugëtimit të UMIB-it për të parë dhe analizuar të arriturat, por edhe sfidat. Thënë ndryshe, këta hapa që janë bërë janë treguesit më të mirë të performancës, që ofron një pasqyrë reale për institucionin tonë. Si të tilla ato paraqesin një realitet, që na ndihmon të përmirësohemi përditë. Dhe ne jemi shumë të vendosur që bashkërisht ta shndërrojmë UMIB-in në një rrëfim të suksesshëm.

Ju faleminderit!

Rektori

Prof. Dr. Alush Musaj



Fjala e Rektorit.....	1
HYRJJE	6
TREGUESIT KRYESORË TË PERFORMANCËS	8
1. Mësimdhënia dhe mësimnxënia	8
1.1. Raporti i aplikuesve me numrin e studentëve që pranoen për çdo program të studimit.	8
1.2. Performanca akademike e studentëve.....	8
1.3. Braktisja e studimeve.....	8
1.4. Transferimi i studentëve prej një Universiteti në një Universitet tjetër	8
1.5. Diplomimi i studentëve	9
1.6. Të diplomuarit tanë.....	9
1.7. Mësimdhënia	9
1.8. Raporti teori-praktikë	9
1.9. Numri i programeve të reja në tre vitet e fundit	10
2. Zhvillimi i cilësisë.....	10
3. Hulumtimi shkencor.....	Error! Bookmark not defined.
3.1. Publikimet shkencore	10
3.2. Konferencat shkencore	10
3.3. Projektet hulumtuese	11
3.4. Citimi i publikimeve shkencore.....	11
3.5. Bashkëpunimi me industrinë	11
4. Shërbimi ndaj komunitetit/shoqërisë.....	11
4.1. Ofrimi i trajnimeve përmes Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në kuadër të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”	11
4.2. Anëtarësia në borde dhe komisione jashtë Universitetit	12
4.3. Aktivitetet e mediave.....	12
4.4. Pjesëmarrja në aktivitete publike jashtë Universitetit	12
5. Bashkëpunimi ndërkombëtar.....	12
5.1. Aktivitetet zyrtare ndërkombëtare	12
5.2. Bashkëpunimet e përgjithshme shkencore	13
6. Mjedisi universitar.....	13
6.1. Kënaqësia e stafit.....	13
6.2. Kënaqësia e studentëve.....	13
6.3. Aftësitë dhe kualifikimi i të diplomuarve.....	13
6.4. Biblioteka.....	14
6.5. Laboratorët.....	14
6.6. Paisjet teknologjike.....	14
6.7. Përshtatshmëria dhe cilësia e objekteve	14



7. Financat dhe Administrata	14
7.1. Buxheti.....	15
8. Resurset Humane.....	15
8.1. Personeli	15
8.2. Stafit teknik.....	16
8.3. Raporti student/staf.....	16
8.4. Promovimi	16
8.5. Trajnimi	16
8.6. Qarkullimi i stafit.....	16
9. Promovimi i UMIB	16
9.1. Numri i vizitorëve të web faqes në vit, për tre vitet e fundit	17
9.2. Rangimi në webomatrix për tre vitet e fundit.....	17
9.3. Numri i miqve të UMIB në rrjetet sociale	17
9.4. Numri i videove promovuese të UMIB	17
9.5. Numri i dokumenteve të publikuara që përmbajnë statistika positive për UMIB	17
9.6. Numri i storieve të suksesit të publikuara për studentët aktualë	17
9.7. Numri i storieve të suksesit për studentët alumni.....	17
9.8. Numri i aktiviteteve të zhvilluara me studentë tre vitet e fundit	17
9.9. Numri i trajnimeve të ofruara për studentë dhe alumni.....	17
9.10. Numri i seancave të informimit në kampus,.....	17
9.11. Numri i intervistave virtuale,.....	17
9.12. Numri i rishikuar i CV-ve, letrave motivuese, dhe dokumenteve përcjellëse si portfoliot.	17
9.13. Numri i asistimeve për studentët në studime postdiplomike dhe punësim.....	17
9.14. Numri i aktiviteteve të organizuara dhe koordinuara në shërbim të studentëve	17
9.15. Numri i seancave këshilluese dhe orientuese në karrierë	17
9.16. Numri i aktiviteteve që sigurojnë krijimin e një mjedisi mikpritës që respekton prejardhjet, besimet dhe qëllimet unike të studentëve.....	17
PËRFUNDIM	18



Lista e shkurtesave

KQSCV	Komisioni qendror për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin
PSUMIB	Plani strategjik i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”
TKP	Treguesit Kryesorë të Performancës
UMIB	Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”



HYRJE

Suksesi nuk është një listë e fjalëve, tabelave dhe figurave me 'shkëlqim'.

Suksesi ka të bëjë me kontributin e kujtdo që dëshiron të që institucioni ku punon të jetë i shkëlqyeshëm.

Çfarë janë treguesit kryesorë të performancës?

Treguesit kryesorë të performancës të arsimit të lartë janë vlera të matshme të përdorura nga institucionet arsimore për të matur dhe ndjekur përparimin e tyre në objektiva specifike. Për më tepër, këta tregues të performancës ndihmojnë institucionet arsimore të monitorojnë dhe vlerësojnë se sa mirë ata performojnë dhe drejtojnë formulimin e politikave si dhe përcaktimin e synimeve të tyre. Treguesit kryesorë të performancës janë masat që ofrojnë informacion dhe të dhëna statistikore që lejojnë krahasimin dhe përcaktimin e përparimit drejt një qëllimi të caktuar. Konsiderohen një mjet i rëndësishëm administrativ për të monitoruar progresin drejt arritjes së qëllimeve strategjike:

- Janë masat që ofrojnë informacion dhe të dhëna statistikore që lejojnë krahasimin dhe përcaktimin e përparimit drejt një qëllimi të caktuar.
- Janë një mjet i rëndësishëm administrativ për të monitoruar progresin drejt arritjes së qëllimeve strategjike.
- Janë tregues statistikorë që ofrojnë një masë subjektive për performancën e institucioneve të arsimit të lartë si masa numerike të shkallës së arritjeve të qëllimeve.

Treguesit kryesorë të performancës janë një nga shumë mjete që ndihmojnë për t'iu përgjigjur një pyetjeje shumë të rëndësishme: si e dimë se çfarë kemi arritur?

Në të njëjtën kohë, në funksion të krahasimit me institucionet e tjera të arsimit të lartë, përmes treguesve kryesorë të performancës, marrin përgjigje pyetjet e mëposhtme:

- Ku jemi në krahasuar me të tjerët?
- Cilat janë fushat e dëshiruara për përmirësim?
- Cilat janë universitetet me rezultate me të mira për të krahasuar aktivitetet tona?
- Si të përqafojmë stilin e këtyre universiteteve?
- Si mund të arrijmë më shumë përsosmëri sesa këto universitete

Por, pse na duhen treguesit e performancës?

- Ata mund të tregojnë se sa mirë po funksionon diçka;
- Ata mund të mbështesin vlerësimin, vendimmarrjen e informuar nga provat/faktet/të dhënat, drejtimi strategjik, formimi i politikave dhe menaxhimi i Universitetit
- Ata mund të japin të dhëna për performancën e përgjithshme;
- Ata mund të kontribuojnë në pamjen e përgjithshme të asaj që po bën Universiteti;
- Ata identifikojnë fushat për përmirësim dhe zhvillim;
- Ata mund të tregojnë se ku duhet të ndërhyjnë;



- Ato kontribuojnë në promovimin e përmirësimit të vazhdueshëm;
- Ato kontribuojnë në promovimin e një mjedisi organizativ të mësimi;
- Ata mund të përcaktojnë / matin përparimin;
- Ata mund të tregojnë se ku mund t'i adresojnë zhvillimet dhe përmirësimet me studentë.
- Ata mund të modifikojnë kulturën e institucionit.

Cilat janë qëllimet e treguesve kryesorë të performancës

- Të ndihmojë institucionin arsimor për të përcaktuar dhe matur përparimin e tij drejt arritjes së qëllimeve
- Të sigurojë informacion të besueshëm mbi natyrën dhe performancën më të lartë të institucionit arsimor.
- Ti mundësojë institucionit që të krahasojë punën e tij me institucionet e tjera.
- Të ndihmojë në procesin e monitorimit të performancës dhe zhvillimit të tij dhe kontribuon në vijimin e këtyre institucioneve.

Cila ishte metodologjia e zhvillimit të treguesve kryesorë të performancës për UMIB

Komisioni Qëndror për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësit, përgjatë hartimit të këtij dokumenti, është mbështetur në dokumentet e UMIB-it, si Statuti i Përkohshëm, Plani strategjik, tërësinë e rregulloreve dhe materialeve të tjera mbështetëse, si dhe mbi disa modele të treguesve të performancës nga universitete prestigjioze.

Në Planin Strategjik të Universitetit të Mitrovicës, një element kritik në arritjen e suksesshme të qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara ka qenë identifikimi dhe matja e suksesshme e Treguesve kryesorë të performancës (TKP). Gjatë muajve të kaluar, në takime të rregullta të këtij komisioni dhe në koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me menaxhmentin e Universitetit, u identifikuan dhe hartuan treguesit e performancës së UMIB-it.

Paketa e treguesve të performancës, do të plotësohet në çdo vit dhe mbështetur në rezultatet e dala do të planifikohen aktivitetet që synojnë përmirësim dhe zhvillim të mëtejshëm të treguesve specifikë.

Plani Strategjik i UMIB 2018-2021 ka përcaktuar shtatë objektiva kryesore si bazë mbi të cilat Universiteti do të arrijë vizionin e tij gjatë kësaj periudhe. Me qëllim të përmbushjes së këtyre objektivave, janë identifikuar një numër i Treguesve kryesorë të performancës të cilët do t'i praqesim në vijim.



TREGUESIT KRYESORË TË PERFORMANCËS

1. Mësimdhënia dhe mësimnxënia

Procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies konsiderohet si shtylla kurrizore e aktivitetit akademik të një Universiteti. Ka të bëjë me të mësuarit e studentëve për pjesën teorike dhe praktike të disiplinave të ndryshme me qëllim të përgaditjes së tyre për tregun e punës dhe kontributin e tyre për kulturën lokale. Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" ka ofruar gjithnjë programe akademike të një standardi ndërkombëtarë sa i përket përmbajtjes dhe metodologjisë së përdorur. Metodologjitë e mësimdhënies janë në përputhshmëri me zhvillimet e fundit në metodat e mësimdhënies dhe shfrytëzimin e teknologjisë.

Mëposhtë do t'i elaborojmë treguesit e performancës veç e veç që lidhen me mësimdhënien dhe mësimnxënien.

1.1. Raporti i aplikuesve me numrin e studentëve që pranohen për çdo program të studimit

1.1.1. Ky tregues i performancës na tregon raportin ndërmjet aplikuesve për çdo program studimi me numrin e studentëve që pranohen.

1.1.2. Ky tregues i performancës na tregon raportin ndërmjet aplikuesve me numrin e studentëve që pranohen në total si UMIB për tri vitet e fundit.

1.2. Performanca akademike e studentëve

1.2.1. Ky tregues i performancës e mat performancën e studentëve përmes notës mesatare të akumuluar dhe bazuar në specifikat sipas programeve të studimit.

1.2.2. Ky tregues i performancës tregon notën mesatare të studentëve ndër vite gjatë studimeve të tyre deri tani si UMIB për tri vitet e fundit.

1.3. Braktisja e studimeve

1.3.1. Ky tregues paraqet përqindjen e numrit të studentëve të cilët i braktisin studimet në Universitet (për arsye akademike apo jo-akademike) para kompletimit të programit të studimeve me numrin total të studentëve të regjistruar për semestër.

1.4. Transferimi i studentëve prej një Universiteti në një Universitet tjetër

Sipas statutit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini":

1. Studenti mund të bëjë ndërrimin e programit të studimit, duke përfunduar mësimin në një program të studimit dhe duke filluar mësimin në një program tjetër të studimit në njësinë e njëjtë apo në njësinë tjetër akademike të Universitetit.

2. Ndërrimi i programit të studimit është i mundur në mes programeve të studimit, me qëllim të arritjes së nivelit të njëjtë të arsimit në pajtim me dispozitat e këtij Statuti.

3. Gjatë ndërrimit të programit të studimit studentit i lejohet të fillojë programin e ri të studimit nëse së paku 50 % e provimeve janë dhënë me sukses gjatë programit të vjetër të studimeve dhe që pranohen në programin e ri të studimeve.

4. Sipas pikës 3, studentit i lejohet të regjistrohet në programin e ri të studimeve:



- 4.1. Më së paku në vitin e dytë të studimeve ose
 - 4.2. Në vitin e studimeve që vijon pas programit të vjetër të studimeve.
5. Ndërrimi i programit të studimit nuk mund të bëhet nëse studenti duhet sërish të regjistrohet në vitin e parë të studimeve në programin e ri të studimeve, në pajtim me pikat 3 dhe 4.
- 1.4.1. Ky tregues transferi është raporti midis rezultatit të zbritjes së numrit të studentëve që janë transferuar nga Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” prej numrit të studentëve që janë transferuar në universitetin tonë me numrin e studentëve para transferit. Raporti prezantohet si përqindje dhe mund të jetë pozitive duke treguar se universiteti ka shtuar numrin e studentëve apo negative në rastet kur ka rënë në numrin e studentëve.

1.5. Diplomimi i studentëve

- 1.5.1. Ky tregues performancë është një matës i vlerësimit të raportit të studentëve që kanë diplomuar në vit vit krahasuar me totalin e numrit të studentëve që është pritur të diplomojnë nëse secili do të kishte përfunduar studimet me kohë. Treguesi i diplomimit prej 1.0 nënkupton që të gjithë studentët kanë diplomuar me kohë atë vit.
- 1.5.2. Ky tregues performance kalkulohet për secilin fakultet ndaras pasi që dallojnë për nga totali i numrit të semestrave për të kompletuar kërkesat për diplomim. Me grafikë prezantohen: të dhënat e numrit të studentëve që kanë diplomuar të sipas programeve të studimit për të gjitha njësitë akademike dhe raportin ndërmjet studentëve që kanë diplomuar me kohë dhe që është dashur të diplomojnë.

1.6. Të diplomuarit tanë

- 1.6.1. Përmes këtij treguesi të performancës masim numrin e studentëve që kanë kryer studimet bachelor tek ne, të cilët brenda gjashtë muajve të diplomimit: a) janë punësuar, b) kanë vazhduar studimet master, c) nuk janë punësuar dhe d) nuk i kanë vazhduar studimet.

1.7. Mësimdhënia

Ngarkesa mësimore e një profesori është numri ekuivalent i studentëve me ngarkesë të plotë mësimore për profesor.

- 1.7.1. Numri ekuivalent i studentëve me ngarkesë të plotë mësimore për profesor në nivel universiteti, në tre vitet e fundit
- 1.7.2. Numri ekuivalent i studentëve me ngarkesë të plotë mësimore për profesor në nivel të fakulteteve, në tre vitet e fundit

1.8. Raporti teori-praktikë

- 1.8.1. Përmes këtij treguesi të performancës ne e paraqesim lidhshmërinë dhe raportin në mes të teorisë dhe praktikës të lëndëve mësimore sipas fakulteteve



1.8.2. Përmes këtij treguesi të performancës ne e paraqesim lidhshmërinë dhe raportin në mes të teorisë dhe praktikës të lëndëve mësimore në nivel Universiteti

1.9. Numri i programeve të reja në tre vitet e fundit

1.9.1. Ky tregues performance e tregon numrin e programeve të reja në kuadër të Universitetit tonë për tri vitet e fundit.

1.9.2. Ky tregues performance e tregon numrin e programeve të reja sipas fakulteteve për tri vitet e fundit.

2. Zhvillimi i cilësisë

Misioni kryesor i menaxhimit të cilësisë është përmirësimi i vazhdueshëm i njësisve akademike dhe universitetit në tërësi. Procesi i përmirësimit të vazhdueshëm mundësohet nga angazhimi i të gjitha palëve të përfshira dhe gjithashtu rekomandon fuqizimin e pjesëmarrësve, gjë që mundësohet nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve të rregullta të personelit.

2.1. Ekzistojnë mekanizmat për sigurimin dhe zhvillimin e cilësisë në universitet që janë:

2.1.1. Komisioni Qendror i Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit në Nivel të Universitetit;

2.1.2. Zyra Qëndrore për Sigurimin e Cilësisë;

2.1.3. Koordinatorët për sigurim të cilësisë në kuadër të fakulteteve

2.2. Gjithashtu, për funksionimin efektiv të sistemit të cilësisë ne kemi krijuar edhe instrumentet për sigurim të cilësisë që janë pjesë e paketës së instrumenteve në UMIB

3. Hulumtim Shkencor

Në kuadër të planit strategjik të UMIB-it, më 2020 është planifikuar të hartohet plani strategjik për kërkime shkencore. Përveç objektivave strategjike kërkimore, Plani do të përfshijë aktivitete të detajuara mbi hulumtimin dhe mbështetjen e stafit akademik për punë kërkimore shkencore.

Në kuadër të planit strategjik është paraparë themelimi i Qendrës për Kërkim dhe Zhvillim në vitin 2020, në kuadër të së cilës do të funksionojnë Institutet multidisiplinare.

3.1. Publikimet shkencore

3.1.1. Treguesi i performancës që ju referohet publikimeve shkencore shërben si matës i numrit të publikimeve shkencore të publikuara nëpër revista shkencore apo publikimi i librave apo monografive në vit për stafin akademik sipas fakulteteve

3.1.2. Treguesi i performancës që ju referohet publikimeve shkencore shërben si matës i numrit të publikimeve shkencore të publikuara nëpër revista shkencore apo publikimi i librave apo monografive, në vit për stafin akademik si Universitet

3.2. Konferencat shkencore

3.2.1 Ky tregues performance e mat përqindjen e pjesëmarrjes nëpër konferenca internacionale të stafit akademik krahasuar me numrin e përgjithshëm të stafit akademik në universitet për vit [për tre vitet e fundit]



3.2.2. Ky tregues performance e mat përqindjen e pjesëmarrjes nëpër konferenca internacionale të stafit akademik të fakulteteve për vit [për tre vitet e fundit]

3.2.3. Gjithashtu, përmes këtij treguesi të performancës paraqitet numri i konferencave shkencore dhe simpoziumeve të organizuara nga universiteti brenda vitit akademik [për tre vitet e fundit]

3.2.4. Përmes këtij treguesi të performancës paraqitet numri i konferencave shkencore dhe simpoziumeve të organizuara nga fakultetet brenda vitit akademik [për tre vitet e fundit]

3.3. Projektet hulumtuese

3.3.1. Ky tregues performance mat numrit total të projekteve hulumtuese të financuara nga buxheti vjetor (i brendshëm) i universitetit

3.3.2. Ky tregues performance mat numrin total të projekteve hulumtuese të financuara nga agjencionet e jashtme përmes granteve të ndryshme.

3.4. Citimi i publikimeve shkencore

3.4.1. Ky tregues performance e mat numrin e citimeve të punimeve në revistat e publikuara për stafin e rregullt akademik në UMIB [për tre vitet e fundit]

3.4.2. Ky tregues performance e mat numrin e citimeve të punimeve në revistat e publikuara për stafin e rregullt akademik sipas fakulteteve [për tre vitet e fundit]

3.5. Bashkëpunimi me industrinë

Përmes këtij treguesi të performancës ne e matim nivelin e bashkëpunimit me kompanitë prodhuese dhe bizneset që operojnë në vendin tonë.

3.5.1. Numri i takimeve me kompanitë prodhuese brenda vitit [për tre vitet e fundit]

3.5.2. Numri i ndryshimeve të ofruara në programe si pasojë e rekomandimit të kompanive

4. Shërbimi ndaj komunitetit/shoqërisë

Si vlerë e shtuar e rolit të universitetit si një qendër për prodhimin e të diplomuarve të një kalibri të lartë përmes programeve unike në vendin tonë si dhe realizimit të hulumtimeve shkencore me cilësi internacionale, Universiteti i kushton rëndësi shumë të madhe bashkëpunimit me komunitetin gjithashtu. Universiteti luan rol kyç në komunitet përmes kontributit të madh për ofrimin e dijes dhe kontributin në aktivitete shoqërore dhe kulturore.

4.1. Ofrimi i trajnimeve përmes Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në kuadër të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”

4.1.1.1. Numri i projekteve të ofruara/fituara/zhvilluara

4.1.1.2. Numrin e trajnimeve të mbajtura

4.1.1.3. Numrin e anëtarëve të trajnuar nga qendra,

4.1.1.4. Numrin e moduleve të hartuara,



4.1.1.5. Numrin e stafit që kanë ofruar trajnime

4.1.1.6. Numri i certifikatave të lëshuara

4.2. Anëtarësia në borde dhe komisione jashtë Universitetit

4.2.1. Të dhëna rreth numrit të stafit të angazhuar neper borde apo komisione jashtë universitetit për tri vitet e fundit, të ndarë sipas angazhimit.

4.3. Aktivitetet e mediave

4.3.1. Ky tregues performance e mat numrin e aktiviteteve publike të stafit të universitetit si: ligjërata publike, publikime të artikujve të ndryshëm nëpër media, paraqitje të ndryshme nëpër media, etj. si UMIB në vit [për tre vitet e fundit]

4.3.2. Të dhënat rreth numrit të aktiviteteve publike të stafit të universitetit si: ligjërata publike, publikime të artikujve të ndryshëm nëpër media, paraqitje të ndryshme nëpër media, sipas fakulteteve në vit [për tre vitet e fundit]

4.4. Pjesëmarrja në aktivitete publike jashtë Universitetit

Ky tregues performance e mat pjesëmarrjen e vizitorëve të jashtëm në universitet me rastin e aktiviteteve të ndryshme si dhe pjesëmarrjen e stafit të universitetit në aktivitete bamirësie apo vullnetare.

4.4.1. Të dhëna rreth numrit të vizitorëve të jashtëm në universitet me rastin e aktiviteteve të ndryshme

4.4.2. Të dhëna rreth pjesëmarrjes së stafit të universitetit në aktivitete bamirësie apo vullnetare jashtë institucionit.

5. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Universiteti në rolin e tij si institucion i arsimit të lartë, natyrisht, mbështet bashkëpunimin me institucionet akademike ndërkombëtare dhe shoqëritë shkencore në mënyrë që të marrë pjesë në zhvillimet e tanishme shkencore dhe të jetë në hapë me të arriturat e reja shkencore.

Mënyra formale e aktiviteteve internacionale të Universitetit është arritja e memorandumeve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të studentëve me institucione hulumtuese prestigjioze. Aktivitet tjetër shumë i rëndësishëm është bashkëpunimi i fakulteteve me homologët e tyre në institucione tjera akademike dhe hulumtuese përmes hulumtimeve të përbashkëta dhe shkëmbimit të vizitave. Tjetër aktivitet i rëndësishëm është kontributi i njësive akademike nëpër shoqëri shkencore internacionale përmes stafit të tyre, aktivitet ky që e promovon pozitën e Universitetit në komunitetin shkencor ndërkombëtarë.

5.1. Aktivitetet zyrtare ndërkombëtare

5.1.1. Përmes këtij treguesi të performancës ne paraqesim numrin e marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit me institucione të ndryshme;

5.1.2. Përmes këtij treguesi të performancës ne paraqesim numrin e marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit me institucione të ndryshme si fakultete



5.1.3. Numrin e organizatave/institucioneve ndërkombëtare në të cilët është i anëtarësuar Universiteti.

5.2. Bashkëpunimet e përgjithshme shkencore

- 5.2.1. Ky tregues performance përfshin të dhënat brenda vitit rreth aktiviteteve kryesore në të cilat janë të angazhuar personeli akademik sipas klasifikimit më poshtë:
- **Komitetet shkencore.** Numri i personelit akademik i ndarë sipas Fakulteteve të cilët shërbejnë nëpër organizata internacionale shkencore, kulturore dhe profesionale.
 - **Bashkëpunimi ndërkombëtarë.** Numri i aktiviteteve të realizuara ndërmjet Fakulteteve dhe institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare, qoftë në mënyrë individuale apo si grupe.
 - **Joint cooperation.** Numri i aktiviteteve të bashkëpunimit ndërmjet një njësie akademike me një institucion tjetër jashtë Universitetit.
 - **Postet drejtuese.** Numri i personelit akademik që shërbejnë nëpër borde të shoqërive kulturore dhe hulumtuese ndërkombëtare.
 - **Bordet editoriale.** Numri i personelit akademik që shërbejnë nëpër borde editoriale të revistave shkencore ndërkombëtare.

6. Mjedisi universitar

Universiteti gjithmonë ka për qëllim të ofrojë një mjedis i cili shërben si mjet për përmbushjen e objektivave të tij. Kjo përfshin një sistem eficient të menaxhimit, disponimin e burimeve të duhura qoftë njerëzore apo material në mënyrë që të përmirësojë vazhdimisht procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Universiteti ofron kushte të mira mjedisore si për stafin ashtu edhe për studentët në mënyrë që të ndihmojë procesin e edukimit. Klasat dhe laboratorët janë të pajisura me pajisje dhe teknologji moderne, gjithashtu, Fakultet janë të orientuara nga përdorimi i metodave bashkëkohore të mësimdhënies në mënyrë të prodhimit të të diplomuarve sa më kualitativ.

6.1. Kënaqësia e stafit

6.1.1. Ky tregues performance ka të bëjë me matjen e nivelit të kënaqshmërisë së stafit sa i përket shërbimeve dhe çështjeve të ndryshme për të cilat janë hulumtuar përmes pyetësorëve

6.2. Kënaqësia e studentëve

6.2.1. Ky tregues performance e mat nivelin e kënaqshmërisë së studentëve për shërbimet që janë përfshirë në pyetësorë rreth mësimdhënies dhe mësim nxënies, poashtu, edhe për shërbimet e ofruara.

6.3. Aftësitë dhe kualifikimi i të diplomuarve

6.3.1. Ky tregues performance na tregon se sa ju kanë ndihmuar studimet në universitetin tonë studentëve për tu adaptuar në tregun e punës sipas studentëve



6.3.2. Ky tregues performance na tregon se sa ju kanë ndihmuar studimet në universitetin tonë studentëve për tu adaptuar në tregun e punës sipas punëdhënësve

6.4. Biblioteka

Përmes këtij treguesi ne e paraqesim numrin e titujve të librave në bibliotekë në raport me numrin e studentëve si dhe shkallën e qasjes në bibliotekë.

6.4.1. Numri i titujve të librave në bibliotekë në raport me numrin e studentëve, si UMIB

6.4.2. Numri i titujve të librave në bibliotekë në raport me numrin e studentëve, sipas fakulteteve

6.4.3. Shkallën e qasjes në bibliotekë [numri i studentëve të regjistruar krahasuar me numrin total të tyre], sipas fakulteteve

6.4.4. Shkallën e qasjes në bibliotekë [numri i studentëve të regjistruar krahasuar me numrin total të tyre], si UMIB

6.5. Laboratorët

6.5.1. Përmes këtij treguesi e masim numrin e laboratorëve dhe pajisjeve përcjellëse laboratorike në kuadër të universitetit.

6.5.2. Përmes këtij treguesi e masim numrin e laboratorëve dhe pajisjeve përcjellëse laboratorike në kuadër të fakulteteve

6.6. Paisjet teknologjike

Përmes këtij treguesi ne e paraqesim numrin e kompjuterëve për student, gjithashtu, numrin e softuerëve në shërbim të personelit akademik dhe studentëve.

6.6.1. Numri i kompjuterëve për staf akademik si UMIB dhe si fakultete

6.6.2. Numri i kompjuterëve për student si UMIB

6.6.3. Numri i softuerëve në shërbim të personelit akademik si UMIB

6.6.4. Numri i softuerëve në shërbim të studentëve si UMIB

6.7. Përshtatshmëria dhe cilësia e objekteve

6.7.1. Ky tregues performance e mat përshtatshmërinë dhe cilësinë e objekteve në funksion të sigurimit të cilësisë.

7. Financat dhe Administrata

Efiçenca dhe transparenca e sistemit financiar dhe administrativ në Universitetin tonë shërbejnë si bazë për mbarëvajtjen e procesit të ofrimit të arsimit të lartë.

Universiteti i Mitrovicës, fushëveprimin dhe planifikimin e implementimit të politikave programore i realizon bazuar në Planin Strategjik të Arsimit të Lartë në Kosovë për vitet 2017/2021, Planin Strategjik për zhvillimin e Universitetit të Mitrovicës për vitet 2018/2021 dhe



planet e punës për vitet fiskale. Aktivitetet janë të ndërlidhura me burimet financiare të përcaktuara në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitet 2019/2021, Ligjin mbi Buxhetin për vitin fiskal 2019 dhe parashikimet për vitet 2020/2021 si dhe burimet nga donacionet për aktivitete specifike. Buxhetin e Universitetit të Mitrovicës e karakterizon procesi i konsultimeve dhe sistemimi i kërkesave të administratës qendrore dhe njësive akademike të harmonizuar me kufijtë final buxhetor të përcaktuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministria e Financave. Kërkesat janë të harmonizuar me njësitë akademike duke konsideruar që aktivitetet të ndërlidhen me implementimin e përgjegjësive që janë përcaktuar me fushëveprimin e institucionit të Arsimit të Lartë në Kosovë.

Kufijtë e përcaktuar sipas KASH 2019/2021 dhe Ligjit mbi Buxhetin për vitin 2019 justifikojnë masën e mjaftuar buxhetore dhe qëndrueshmëri të burimeve financiare për të realizuar misionin, objektivat dhe aktivitetet që ndërlidhen me dokumentet strategjike të aprovuara nga organet vendimmarrëse të universitetit.

7.1. Buxheti

Ky tregues performance tregon shumën e buxhetit të Universitetit për tri vitet e fundit si dhe tregon format e shpërndarjes së buxhetit.

7.1.1. Shumën e buxhetit të Universitetit për tri vitet e fundit.

7.1.2. Mënyrën e shpërndarjes së buxhetit.

8. Resurset Humane

Universiteti gjithnjë ka besuar dhe beson se cilësia e resurseve humane është esenciale për cilësinë e të diplomuarve kompetentë. Prandaj, procesit të rekrutimit të stafit i kushtohet rëndësi shumë e madhe.

Personeli akademik i UMIB – it në vazhdimësi është i përfshirë në aktivitete shkencore dhe që mundësojnë që ata të mbesin të azhurnuar me zhvillimet e fundit në fushën e tyre. Gjithashtu edhe personeli administrativ nëpërmes trajnimeve do të pajiset me njohuri të reja lidhur me ekzekutimin më të lehtë të detyrave dhe përgjegjësive që i ka për pozitën e punës.

8.1. Personeli

8.1.1. Ky tregues performance e mat numrin e stafit akademik sipas:

- Kualifikimit;
- Gjinisë;
- Thirrjes akademike
- Moshës

8.1.2. Gjithashtu, numrin e stafit administrativ e mbështetës sipas:

- Kualifikimit;
- Gjinisë;
- Moshës



8.2. Stafit teknik

Ky tregues performance e mat numrin e stafit teknik sipas:

- Kualifikimit;
- Gjinisë;
- Moshës

8.3. Raporti student/staf

8.3.1. Ky tregues performance tregon raportin student-personel akademik, student-staf administrative mbështetës dhe student-staf teknik për tri vitet e fundit si UMIB

8.3.2. Ky tregues performance tregon raportin student-personel akademik, student-staf administrative mbështetës dhe student-staf teknik për tri vitet e fundit si fakultete

8.4. Promovimi

Ky tregues performance e mat promovimin e stafit në universitet të ndarë sipas kategorive: Personel akademik, staf administrative dhe mbështetës dhe staf teknik.

8.4.1. Promovimi i stafit akademik brenda vitit si fakultete dhe si UMIB

8.4.2. promovimi i stafit administrativ dhe mbështetës

8.4.3. promovimi i stafit teknik

8.5. Trajnimi

Ky tregues performance paraqet numrin e personelit të cilët kanë përfituar bursa, gjithashtu, paraqet numrin e personelit akademik, administrative dhe mbështetës si dhe teknik që kanë ndjekur trajnime tri vitet e fundit.

8.5.1. Numrin e personelit të cilët kanë përfituar bursa në vit si UMIB dhe sipas fakulteteve [për tre vitet e fundit]

8.5.2. Numrin e personelit akademik, administrativ dhe mbështetës si dhe teknik që kanë ndjekur trajnime tri vitet e fundit.

8.6. Qarkullimi i stafit

Ky tregues performance e mat nivelin e qarkullimit të stafit në vit [për tri vitet e fundit]. Poashtu, paraqet edhe arsyet e qarkullimit të stafit si për shkak të pensionimit; përfundimit të kontratës; dorëheqjes.

8.5.1. Niveli i qarkullimit të stafit për tri vitet e fundit si UMIB dhe si fakultete

8.5.2. Arsyet e qarkullimit të stafit si për shkak të pensionimit; përfundimit të kontratës; dorëheqjes si UMIB dhe si fakultete

9. Promovimi i UMIB

Ky tregues performance e mat promovimin e universitetit, të ndarë sipas kategorive:



- 9.1. Numri i vizitorëve të web faqes në vit, për tre vitet e fundit
- 9.2. Rangimi në webomatrix për tre vitet e fundit
- 9.3. Numri i miqve të UMIB në rrjetet sociale
- 9.4. Numri i videove promovuese të UMIB
- 9.5. Numri i dokumenteve të publikuara që përmbajnë statistika pozitive për UMIB
- 9.6. Numri i storieve të suksesit të publikuara për studentët aktualë
- 9.7. Numri i storieve të suksesit për studentët alumni
- 9.8. Numri i aktiviteteve të zhvilluara me student tre vitet e fundit
- 9.9. Numri i trajnimeve të ofruara për student dhe alumni
- 9.10. Numri i seancave të informimit në kampus,
- 9.11. Numri i intervistave virtuale,
- 9.12. Numri i rishikuar i CV-ve, letrave motivuese, dhe dokumenteve përcjellëse si portfoliot.
- 9.13. Numri i asistimeve për studentët në studime postdiplomike dhe punësim
- 9.14. Numri i aktiviteteve të organizuara dhe koordinuara në shërbim të studentëve
- 9.15. Numri i seancave këshilluese dhe orientuese në karrierë
- 9.16. Numri i aktiviteteve që sigurojnë krijimin e një mjedisi mikpritës që respekton prejardhjet, besimet dhe qëllimet unike të studentëve.



PËRFUNDIM

Për qëllime të përmirësimit të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë, institucionet duhet t'i shqyrtojnë dhe t'i masin treguesit kryesorë të performancës në baza periodike. Edhe në institucion i arsimit të lartë kemi hartuar treguesit kryesorë të performancës përmes të cilëve identifikojmë pikat tona të forta si institucion, por, edhe hapësirat ku kemi nevojë për përmirësim.

Matja dhe raportimi i treguesve të performancës për institucionin tonë do të shërbejë jo vetëm si mjet për ngritjen e cilësisë në ofrimin e arsimit të lartë por edhe si mjet kryesor për menaxhim strategjik më të mirë, po ashtu edhe për ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies duke siguruar që Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” është një institucion që plotëson misionin e tij që të ofrojë mësimdhënie bashkëkohore për përgatitjen e kadrove cilësore në fusha unike për Kosovën, rajonin e më gjerë, i dedikuar të zhvillojë kërkime shkencore, projekte profesionale, këshillime profesionale duke qenë në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm dhe rritjes së mirëqenies dhe avancimit shoqëror.

